

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

**Përkrahje në përmirësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve (RSB) –
Zhvillimi i aplikacionit Windows
Komponenti nr 3.5.3**

Misioni i udhëhequr nga
Søren Netterstrøm, Statistikat e Danimarkës
25-29 Maj 2015

IPA 2012

Emri, adresa, emaili i autorit

*Søren Netterstrøm
Statistics Denmark
Farverstræde 6
DK-4850 Stubbekøbing
Denmark
Tel: +45 5444 0475
Email: sne@viv.dk*

Pwrmbajtja

1. Komente të përgjithshme	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
2. Gjendja aktuale	4
3. Azhurnimi me të dhëna nga ARBK	5
4. Krijimi i Njësive mbi llojin e aktivitetit KAU	5
5. Misioni i radhës.	6
Aneksi 1. Termat e Referencës	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 2. Personat e takuar	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.

Shkurtesat

GSBPM	Modeli i përgjithshëm i procesit të prodhimit statistikor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare
NACE	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev.2
RSB	Regjistri Statistikor i Bizneseve
SBS	Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SQL	Structured Query Language
STS	Statistikat Afatshkurtra
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
TeR	Termat e Referencës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”. Ky është misioni i gjashtë, që i kushtohet Regjistrit Statistikor të Biznesit (RSB) në kuadër të komponentit 3 të projektit.

Qëllimi i këtij misioni ka qenë shqyrtimi i problemeve, që lidhen me azhurnimin e RSB-së me të dhëna të reja nga ARBK, dhe krijimi i një versioni plotësisht të azhurnuar të RSB-së, i gatshëm për përdorim. Është mbajtur një seminar i shkurt me përdoruesit kyç, për të demonstruar mundësinë e përdorimit të aplikacionit Excel për nxjerrjen e ekstrakteve standarde nga RSB-ja. Por, kjo qasje kërkon një akordim më të mirë, si të përmbajtes, ashtu edhe të plotësimin të kriterëve për sigurinë e të dhënave (konfidencialitetit).

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Gjendja aktuale

Gjatë këtij misioni ka përfunduar ngarkimi i të dhënave nga ARBK. Kjo përfshin ngarkimin e të dhënave nga ARBK të marra në Janar, si dhe azhurnimin me të dhënat e marra në Maj. Gjatë procesit janë paraqitur një numër i vogël problemesh, të cilat janë rregulluar.

Procedurat për azhurnimin e të dhënave prej ATK-së (qarkullimi dhe indikatorët e tjerë) dhe TRUST (të dhënat mbi punësimin) janë rishikuar dhe ngarkuar. Gjithashtu, janë risihikuar procedurat për plotësimin me kodet e aktivitetëve nga anketat dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që kodet e aktivitetit ‘mbyllen’ kur ndryshojnë ose konfirmohen nga të dhënat e anketës.

Si rezultat, ASK tani ka një RSB të re, të gatshme për ta futur në përdorim. Gjatë takimit me përdoruesit kyç, është theksuar që RSB bazohet në njësitë statistikore, Ndërmarrjet dhe Njësitë Lokale në vend të njësive administrative, që janë përdorur në të kaluarën. Anketat dhe llogaritë kombëtare duhet gjithashtu të kalojnë në përdorimin e këtyre njësive, sa më shpejt të jetë e mundur. Për anketat, kjo mund të bëhet kur të merren mostrat e radhës.

Qëllimi është të krijohet një mjet, që i mundëson përdoruesve kyç të nxjerrin vetë ekstraktet e dhënash nga RSB. Megjithatë, të dhënat nga ARBK-ja dhe ATK-ja merren me kusht që përdorimi i tyre është shumë i kufizuar dhe ASK nuk duket të ketë ndonjë politikë të përgjithshme për sigurinë e të dhënave dhe politikë të konfidencialitetit. Si rrjedhojë, do të ketë kufizime në llojin e të dhënave, të cilat mund të nxjerrin përdoruesit, si në aspektin e kodit të aktivitetit, ashtu edhe në nivelin e detajeve për qarkullimin/punësimin.

Kjo duhet të definohet dhe implementohet në të ardhmen.

Sipas konsulentëve, çështja e sigurisë së të dhënave dhe konfidencialiteti në përgjithësi duhet të adresohet nga niveli më i lartë i menaxhmentit të ASK-së. Realizimi i RSB është i mundshëm

vetëm me raportet e mira me burimet administrative (ARBK, ATK, TRUST), por ASK mund të përfitojë nga burimet administrative edhe në fushat e tjera. Nëse do të ketë keqpërdorim të dhënave (për qëllime jo-statistikore), kjo mund të çojë në një situatë, ku ofruesit e të dhënave do të ndërprejnë të dhënat, dhe kjo do të kishte pasoja shumë serioze për ASK-në.

3. Azhurnimi me të dhëna nga ARBK

Në përgjithësi azhurnimi me të dhëna nga ARBK është i drejtpërdrejtë.

Të dhënat nga ARBK dërgohen në një format të caktuar dhe kjo ka shkatuar që të dhënat jo gjithmonë të transmetohen saktë. Megjithatë kjo është mbuluar mirë nga procedurat e azhurnimit. Është rekomandur të rishikohet formati për dërgimin e të dhënave, por kjo duket të mos jetë urgjente.

Shumica e azhurnimeve janë automatike dhe numri i transaksioneve dhe mesazheve të papërfunduara është i vogël.

Është anashkaluar një test për disa njësi lokale në të njëjtin vendbanim pasi ka prodhuar shumë mesazhe dhe nuk ka resurse të mjaftueshme të merren me ato. Është rekomanduar gjithashtu, që kur përgatiten mostrat duke përdorur njësinë lokale, të merren masat për të verifikuar dhe korrigjuar njësitë lokale. Anketa e regjistrit të biznesit dhe ASN mundën gjithashtu të ofrojnë informata më të mira mbi njësitë lokale. Kjo çështje mund të diskutohet më tutje në misionin e ardhshëm.

6 njësi kanë ndërruar numrin e tyre fiskal midis Janarit dhe Majit. Kjo ka shkaktuar një transaksion të papërfunduar, pasi nuk dihej si mund të ndodhte kjo. Kjo duhet të kontrollohet edhe më tej, në mënyrë që të përcaktohet se si të trajtohen këto raste dhe nëse disa (shumica) mund të trajtohen në mënyrë automatike. Në këtë kontekst ekziston po ashtu një çështje tjetër lidhur me të dhënat nga ATK-ja, pasi këto janë të lidhura me numrin fiskal. Nëse nuk trajtohen në mënyrën e duhur, disa të dhëna nga ATK-ja mund të humbin ose të mos alokohen saktë te ndërmarrjet. Këto çështje do të diskutohen edhe më tej në misionin e radhës.

Kodet e aktivitetit në ARBK shkaktojnë një numër mesazhesh. Mund të mos ketë asnjë aktivitet kryesor ose mund të ketë më shumë se një. Në të dyja rastet krijohen mesazhe, që duhet të kontrollohen. Por, numri i tyre është i vogël dhe mund të trajtohen.

Në disa raste, ka disa ndryshime në kodet e aktivitetit që janë caktuar nga burimet statistikore. Këto nuk janë azhurnuar automatikisht, megjithatë ato duhet të kontrollohen për të përcaktuar nëse ka nevojë të azhurnohet kodi i aktivitetit të Ndërmarrjes.

4. Krijimi i Njësive mbi llojin e aktiviteti KAU

Siç është diskutuar në raportin e kaluar, çdo kod i aktivitet që i shtohet ndërmarrjes ka për efekt krijimin e Njësive mbi llojin e aktivitetit (KAU). Numri i ndërmarrjeve, me një ose më shumë kode të aktiviteteve sekondare është i ulët, pasi këto mblidhen përmes anketave (në përputhje me udhëzuesit e BE-së) dhe aktiviteti sekondar do të duhej të mbulonte një pjesë të konsiderueshme të punësimit dhe qarkullimit.

Qëllimi bazik i KAU është të sigurojë, që të dhënat mbi punësimin dhe të dhënat financiare mund të ndahen në nivel të KAU për kompanitë e mëdha për të fituar një pasqyrë sa më të saktë kur prodhohen të dhëna statistikore sipas aktivitetit-grupeve. Kjo është shumë e rëndësishme si për statistikatat afatshkurtra, ashtu edhe për Llogaritë Kombëtare. Llogaritë Kombëtare do të përdorin të dhënat e marra nga ATK (qarkullimin dhe indikatorët e tjerë). Këto janë marrë në nivel të njësisë

fiskale dhe janë konvertuar në të dhëna në nivel ndërmarrjeje. Nëse do të mund të procesoheshin në nivel KAU, do të rritej edhe më shumë vlera e tyre.

Me përdorimin e të dhënave nga statistikat afatshkurta (dhe burimet e tjera?) mund të jetë e mundur për secilën Ndërmarrje, që ka disa KAU, të krijohet tabela për secilin KAU me përqindje të punësimit/qarkullimit (ose vlerën e shtuar) që KAU e mbulon. Për secilën ndërmarrje kjo sigurisht duhet të jetë baras me 100%.

Nëse krijohet një tabelë e tillë, raportet e bazuara në të dhënat e ATK-së mund t'i shfrytëzojnë këto tabela për të përmirësuar vlerësimet sipas kodit të aktivitetit.

Kjo çështje mbetet për tu investiguar edhe më tutje. Kushti i parë është të ekzistojnë disa të dhëna dhe këto të mund të azhurnohen rregullisht (në baza vjetore?). Kushti i dytë është që ASK të ketë resurse në dispozicion për të ndërmarrë këtë detyrë. Mund të mos jetë stafi i Regjistratit të Bizneseve, mund të jetë stafi i statistikave afatshkurta (burimi më i mundshëm) ose Llogarive Kombëtare (përdoruesi primar). Konsulenti rekomandon që çështja të diskutohet në ASK dhe pastaj të adresohet në misionin e radhës.

5. Misioni i radhës.

Misioni i radhës, me Søren Netterstrøm, është caktuar të mbahet nga data 24 Gusht 2015.

Veprimet, që duhet të finalizohen para misionit të radhës

Veprimet	Personi përgjegjës
Rishikimi i transaksioneve dhe mesazheve të papërfunduara	Muhamet Kastrati
Azhurnimi me të dhëna nga ARBK deri në fund të Qershorit	Muhamet Kastrati
Përcaktimi i rolit të përdoruesve për Excel aplikacionin	Muhamet Kastrati
Ngarkimi i aktiviteteve sekondare	Muhamet Kastrati
Inicimi i diskutimeve për KAU	Muhamet Kastrati

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së
KS12 IB ST 01
Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 3: Statistikat e Biznesit

Aktiviteti 3.5.3: Përkrahje në përmirësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve (RSB) – Zhvillimi i aplikacionit Windows

Orari:

TeR –data e përgatitjes: 11 Maj 2015

Fillimi / fundi i aktivitetit: 25-29 Maj 2015

Koha e raportimit: 5 Qershor 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
Rezultati obligativ 3.5.2	Përkrahje për përmirësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve (RSB)	<ul style="list-style-type: none"> Raporti misionit, që paraqet fushat më të rëndësishme të veprimit, për përmirësimin e regjistrimit të bizneseve, i publikuar në webfaqen e projektit Afati kohor dhe harta rrugore për përmirësim, të zhvilluara Rekomandimet për procedurat e reja për të siguruar përditësimin e RSB-së nga burimet që janë në dispozicion Drafti i tabelës korresponduese midis NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev 2. i përditësuar Tabela korresponduese midis NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev 2, e finalizuar 	<ul style="list-style-type: none"> Raportet tremujore të Binjakëzimit Raportet e Misionit Harta rrugore Afatet kohore 	<ul style="list-style-type: none"> Kapaciteti i mjaftueshëm absorbimi Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve Termat e referencës, të përpiluara me kohe, që paraqesin në detaje detyrat, (inputi), rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitetet dhe agjendën

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 3.5.3

Ky mision është vazhdim i misionit të kaluar mbi RSB-në Prill të vitit 2015.

ASK tani ka marr një seri të re të të dhënave nga ARBK si dhe të dhëna nga ATK (raporte tremujore dhe vjetore si dhe të dhëna mujore sa i përket TVSH-së). Të dhënat që i përkasën punësimit janë marrë nga agjencioni i TRUST-it.

Gjatë misionit të radhës të dhënat nga ATK dhe TRUST janë ngarkuar në RSB. Kodet e aktivitetit janë ngarkuar nga 3 anketa statistikore. Është tentuar të bëhet një azhurnim duke përdorur të dhënat e reja nga ARBK. Megjithatë, për shkak të problemeve që janë paraqitur dhe mungesës së kohës, këto procese janë ndërprerë.

Më tej është vërejtur, gjatë misionit të fundit, që të dhënat nga ARBK nuk duken të kompletuara, një numër shumë i madh i njësive lokale ligjore mungonin. Ky problem duhet të zgjidhet para këtij misioni, ku do të tentohet të bëhet një azhurnim i ri i RSB-së, duke përdorur të dhënat nga ARBK.

Gjatë misionit, do të mbahet një seminar 1 ditor me përdoruesit e RSB-së. Qëllimi i seminarit është të mësohen përdoruesit të nxjerrin ekstrakte të thjeshta nga RSB. Disa ide për këto ekstrakte janë prezantuar gjatë misionit të kaluar dhe do të jenë të mirëseardhura sugjerimet nga përdoruesit.

Rezultatet e pritura të aktivitetit 3.5.3:

Raporti i misionit – Përshkrimi i progresit të bërë nga misioni i kaluar.

Azhurnimi i afatit kohor

Sugjerimet për Termat e referencës për aktivitetet e tjera në lidhje me RSB.

Stafi i ASK-së:

Z. Muhamet Kastrati, Menaxher i Databazës, muhamet.kastrati@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive

Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare

Z. Søren Netterstrøm, Ekspert i Statistikave të Biznesit, Statistikat e Danimarkës, sne@viv.dk

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA Asistente, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetin

Ky mision është i bazuar mbi planin e përgatitur nga ekspertët e vendeve anëtare dhe eksperti i ASK-së gjatë misionit të fundit.

Eksperti dhe homologët e tij në ASK kanë konkluduar në misionin e fundit që, meqenëse projekti është zgjidhur deri në fillim të Marsit 2016, ende mund të arrihet qëllimi i vendosur për këtë projekt.

Gjatë këtij misioni eksperti dhe ASK do të vazhdojnë të zhvillojnë databazën.

Veprimet, që duhet të finalizohen para misionit të radhës

Veprimet	Personi përgjegjës
Ngarkimi i RSB-së me versionin e marrë nga ARBK	Muhamet Kastrati
Ngarkimi i kodit të aktivitetit nga SBRS, ASN	Muhamet Kastrati

dhe statistikat afatshkurta	
Ngarkimi i të dhënave të taksave për Ndërmarrjet	Muhamet Kastrati

Aktivitetet, që duhet të ndërmerren si përgatitje për misionin:

- Të gjitha raportet e Komponentit 3 Statistikat e Biznesit mund t'i gjeni në dst.dk/kosovo

Aktivitet e pritura janë:

- Analizimi i aktiviteteve nga misioni i fundit
- Zhvillimi i mëtejme i databazës
- Azhurnimi i RSB duke përdorur të dhënat nga ARBK

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim
- Plani i detajuar për aktivitetet tjera të kompletohet, sa i përket RSB-së në Kosovë nga ana e programit të binjakëzimit

Aneksi 1. Programi - Maj 2014

Dita	Vendi	Koha	Aktiviteti
1	ASK	09.00	ASK: Gjendja aktuale e RSB
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Planifikimi i javës. Zhvillimi i RSB
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	Zhvillimi i RSB
2	ASK	09:00-16:00	Zhvillimi i RSB
3	ASK	09:00-16:00	Zhvillimi i RSB
4	KAS	09:00-16:00	Seminari me përdoruesit
5	KAS	09:00	Shkrimi i raportit
		10:00	Takim mes ekspertit, udhëheqesit të komponentit, udhëheqesit të projektit dhe RTA
		10:30	Pushim për kafe
		10:00	Shkrimi i raportit
		12:00	Dreka
		13:00	Shkrimi i raportit

Aneksi 2. Personat e takuar

Stafi i ASK-së:

Z. Muhamet Kastrati, Menaxher i Databazës, muhamet.kastrati@rks-gov.net

Ekipi i Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit Mr. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare

Z. Søren Netterstrøm, Ekspert i Statistikave të Biznesit, Statistikat e Danimarkës, sne@viv.dk

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA Asistente, nzogaj@yahoo.com